

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E STANDARDIZIMIT

ANALIZË VJETORE - 2015

Zbatimi i detyrave që dalin nga Plani Kombëtar për Integrimin Europian (PKIE), i cili ka reflektuar detyrimet e DPS ndaj nenit 75 të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit, si dhe rekomandimet e raportit analitik të KE-së të vitit të kaluar ka qenë fokusi kryesor i punës sonë për këtë vit.

Bazuar në sa më sipër prioritetet tona në terma afatshkurtër dhe afatgjatë janë:

- Ngritja dhe funksionimi i një sistemi kombëtar për standardizimin në përputhje me parimet dhe rregulloret e BE-së në këtë fushë;
- Përmirësimi i kuadrit ligjor të DPS-së dhe zhvillimi i të gjitha aktiviteteve të saj, si Organi Kombëtar i Standardeve në vend, sipas praktikave të organizmave evropiane të standardizimit (EN, CENELEC dhe ETSI);
- Progres i vazhdueshëm në adoptimin e standardeve evropiane dhe ndërkombëtare;
- Rritja e ndërgjegjësimimitmbi rolin e standardeve në tregti;
- Pjesëmarrja në punën Evropiane e ndërkombëtare të standardizimit dhe trajnimi i stafit me praktikat dhe procedurat e punës së organizmave homologe;
- Plotesimi në vazhdimësi i kriterëve për t'u bërë anëtar me të drejta të plota në CEN&CENELEC;

Përafrimi i legjislacionit

Në kuadrin e përafrimit të legjislacionit tonë me atë të vendeve të BE-së dhe bazuar edhe nga sa parashikohet në PKIE, gjatë këtij viti është miratuar:

1. Ligji nr.53, datë 21.5.2015 “Për disa ndryshime në Ligjin nr.9870, datë 4.2.2008, “Për Standardizimin”” të ndryshuar.

Miratimi i këtij Ligji rregullon kuadrin ligjor dhe procedurat e punës në DPS, lidhur me emërimin dhe shkarkimin e Drejtorit të Përgjithshëm të saj dhe marrëdhëniet e punësimit për të gjitha nivelet e punonjësve të kësaj Drejtorie dhe e sjell atë në përputhje me dispozitat e Ligjit nr.152/2013 „Për nëpunësin civil“ dhe akteve të tjera në zbatim të tij.

Gjithashtu, ndryshimet e bëra në këtë Ligj kanë sjellë transpozimin pjesërisht të Rregullores nr.1025 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 25 Tetor 2012 “Mbi Standardizimin Europian, që amendon Direktivat e Këshillit 89/686/EEC dhe 93/15/EEC dhe Direktivat 94/9/EC, 94/25/EC, 95/16/EC, 97/23/EC, 98/34/EC, 2004/22/EC, 2007/23/EC, 2009/23/EC dhe 2009/105/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit dhe që shfuqizojnë Vendimin e Këshillit 87/95/EEC dhe Vendimin No 1673/2006/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit”, duke përafuar plotësisht dispozitat e këtij Ligji me pikën 2 të nenit 26 të Rregullores së BE nr.1025/2012.

2. Vendimi nr.754, datë 16.09.2015, i Këshillit të Ministrave „Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për sistemin e menaxhimit të standardeve“.

Objekti i këtij Vendimi është krijimi me akt ligjor i bazës së të dhënave shtetërore për DPS që quhet Sistemi i Manaxhimit të Standardeve (SMS) dhe sjell përputhshmërinë me dispozitat e Ligjit nr.10325, datë 23.09.2010 “Për bazat e të Dhënave Shtetërore”, ku përcaktohet se baza e të dhënave shtetërore krijohet me akt ligjor (ligj ose me VKM), si dhe përputhshmërinë me aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij, një nga të cilët është edhe Vendimi nr.945, datë 2.11.2012 i Këshillit të Ministrave për miratimin e rregullores “Administrimi i Sistemit të Bazës së të Dhënave Shtetërore”.

3. Vendimi nr.138, datë 18.2.2015 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në Vendimin nr.433, datë 5.5.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe kompetencat e Bordit Drejtues të DPS””.

Në Vendimin nr.138/2015 janë bërë vetëm rregullimet për shkak të ndryshimeve të emërtimeve dhe ndarjes së përgjegjësisë të disa nga ministrinë që kanë përfaqësues në Bordin Drejtues të DPS. Në mënyrë që të evitohet nevoja për ndryshime të tjera në të ardhmen për shkaqe të ndryshimeve të mundshme të emërtimeve të ministrive ato janë zëvendësuar me fushat e përgjegjësisë të tyre, p.sh. ministria përgjegjëse për ekonominë, ministria përgjegjëse për bujqësinë, etj.

Adoptimi i standardeve Europiane

Gjatë vitit 2015 kanë funksionuar 61 Komitete Teknike (KT) të cilët janë pasqyrë e KT-ve të CEN dhe CENELEC. Në këto KT për adoptimin e standardeve të planifikuara nga Bordi Teknik i DPS-së janë aktivizuar rreth 170 ekspertë, të cilët vijnë nga sektorët privat dhe shtetëror, institucione shkencore, administrata publike, etj. Janë mbajtur dy mbledhje të Bordit Teknik dhe rreth 200 mbledhje të Komiteteve Teknike.

Gjithsej janë adoptuar **3,122** standarde evropiane e ndërkombëtare (ISO dhe IEC) përfshi edhe amendamente e dokumenta standardizimi, nga të cilat:

2,129 standarde evropiane (CEN, CENELEC dhe ETSI) të adoptuara si standarde shqiptare; **498** janë standarde ndërkombëtare, **209** janë dokumenta standardizimi dhe **286** janë amendamentet e standardeve, kryesisht evropiane.

Të programuara në programet 6 mujore të punës të miratuara nga Bordi Teknik janë **3,101** - të realizuara **3,122**, ku diferenca e tejkaluar është 21 standarde, të cilat janë adoptime me procedurë të përshpejtuar në plotësim të kërkesave të klientëve.

Numri më i madh i standardeve të adoptuara i përket fushës së telekomunikacionit (619 standarde), pasuar nga cilësia e ujit, ajrit dhe tokës (213), e me radhë materialet dhe pajisjet gjysëmpërçuese, komponentët elektromekanikë dhe strukturat mekanike për pajisjet (206) dhe siguria teknike dhe ambienti (203).

Janë adoptuar në masën 100% standardet Evropiane të harmonizuara si Standarde Shqiptare të harmonizuara.

Adoptimi i standardeve është bërë me metodën me perkthim te faqes së parë. Numri i standardeve të perkthyer në shqip është shumë i vogël krahasuar me totalin e adoptimeve.

Informimi, publikimi dhe transparenca ndaj qytetarëve:

Në dallim nga vitet e kaluara, gjatë 2015 në faqen e internetit të DPS www.dps.gov.al është bërë publikimi i standardeve Shqiptare me perkthim të fushës/qëllimit të standardit.

Po kështu, janë publikuar dhe shpërndarë 4 Buletinët Informativë (nr.61-64) të planifikuar në programin e punës 2015.

Të tjera publikime në faqen e internetit të DPS-së janë:

Programet e punës së standardeve për të marrë mendimet dhe/ose komentet për projektstandartet e planifikuara çdo gjashtë muaj. Periudha e marrjes së komenteve është 60 ditë nga data e publikimit.

Programi i Transparencës, në zbatim të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.

Mbledhjet e Bordeve të DPS-së (Bordi Drejtues dhe ai Teknik), Komitetet Teknike, takimet me palët e interesuara dhe pjesëmarrja në panairët, takimet kombëtare e ndërkombëtare të Drejtorit të Përgjithshëm dhe stafit, si dhe

notifikimet e programeve 6 mujore të punës për adoptimin e standardeve; dhe

10 notifikime të projekt akteve ligjore e nënligjore në kuadër të OBT dhe CEFTA (3 pr.ligje dhe 7 pr.VKM).

Është rritur ndjeshëm numri i artikujve e informacioneve promovuese lidhur me rolin e standardeve në ekonomi dhe në sigurinë e cilësinë e jetës së qytetarëve dhe atë të mjedisit. Numërohen mbi 30 artikuj/njoftime e shkrime sensibilizuese të publikuara sa i përket zhvillimeve në fushën e standardeve.

Është krijuar rubrika Dialog me Palët e Interesuara në faqen e internetit të DPS, e cila komunikon pothuajse çdo ditë me qytetarët, duke dhënë informacione mbi statusin e standardeve, fushat dhe Komitetet Teknike të angazhuara për secilin standard, si dhe Këndi i Standardeve, i cili është ri-freskuar 2-3 herë në javë.

Në faqen e internetit të DPS-së jepen procedurat për kërkimin dhe gjetjen e Standardeve Shqiptare. Faqja përmban të gjithë buletinët informativë dhe Katalogun e Standardeve Shqiptare 2015, si dhe guidën për përdorimin e saj.

Publikimet dhe Shpërndarja e tyre

Të gjitha standardet puro shqiptare në fuqi, ato të adoptuara si dhe standardet e shfuqizuara gjatë një viti gjenden në Katalogun e Standardeve Shqiptare, që publikohet çdo vit. Katalogu është në format letër dhe elektronik me CD. Gjatë 2015 janë shpërndarë:

- 250** – Katalogë të Standardeve Shqiptare 2015 (**150** në format letër dhe **100** me CD);
- 200** – Buletinë informative (të shpërndarë elektronikisht).

Mediat Sociale

Të gjitha njoftimet dhe publikimet e pasqyruara në faqen e internetit të DPS-së janë publikuar edhe në Mediat Sociale ([DPS Facebook](#), [DPS Google+](#), [DPS LinkedIn](#)), ku janë ndjekur edhe aktivitetet e ministrive, institucioneve, bizneseve vendase, organizmave evropiane e ndërkombëtare të standardizimit (CEN, CENELEC, ISO, IEC, ETSI, ITU etj) dhe trupave kombëtare të standardizimit (AENOR, AFNOR, BSI, DIN etj).

Numri i “ndjekësve” të DPS-së përmes këtyre profileve për vitin 2015 është:

- DPS Facebook rreth **670**;
- DPS Google+ rreth **6,362** shikime;

Shërbimi ndaj klientëve

Është realizuar plaini i 2015 për ri-shtypjen dhe formatimin e 50 standardeve puro kombëtare (SSH) kryesisht të fushave - bimë mjekësore dhe lëndë plastike.

Shitja e standardeve

Gjatë periudhës Janar – 28 Dhjetor 2015 janë shitur gjithsej:

- **1,865** standarde nga të cilat **1,601** janë standarde Evropiane, kryesisht të fushave të ndërtimit dhe sigurinë e pajisjeve nën presion (bombolat e gazit për ngrohje e përdorim shtëpiak).

Marrëveshjet e bashkëpunimit

Bazuar në Urdhërin e Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, nr.2572, datë 31.3.2015 “Për zbatimin e aktiviteteve për thellimin e bashkëpunimit ekonomik dhe tregtar me Kosovën” në Korrik 2015 u nënshkrua një Marrëveshje e re mes DPS dhe Agjencisë Kosovare të Standardeve (AKS).

Gjithashtu, në Tetor 2015 DPS nënshkroi një Memorandum Mirëkuptimi me Zyrën Çeke për Standardet, Mëtrologjinë dhe Testimin, e cila rrit bashkëpunimin midis dy institucioneve respektive dhe do të ndihmojë DPS-në në plotësimin e kriterëve të antarësimit të plotë në CEN&CENELEC.

Objektivat për 2016 janë:

- Përputhja e legjislacionit vendas me atë evropian në fushën e standardizimit;
- Progres në adoptimin e EN-ve si SSH sidomos për fushat prioritare të ekonomisë;
- Rritja e pjesëmarrjes në punën evropiane të standardeve;
- Plotësimi i kriterëve për anëtarësim me të drejta të plota në CEN&CENELEC;
- Rritja e ndërgjegjësimit të operatorëve ekonomikë vendas dhe konsumatorit mbi rolin dhe rëndësinë e përdorimit të standardeve Europiane në produktet dhe shërbimet e ofruara në treg;
- Rritja e ndërgjegjësimit në lidhje me pjesëmarrjen e palëve të interesuara në procesin e standardizimit;
- Sigurimi i transparencës dhe informimit të publikut të gjerë për standardet dhe aktivitetet në fushën e standardizimit;
- Forcimi i kapaciteteve të DPS nëpërmjet trajnimeve të stafit.

Produktet gjatë 2016

Disa nga produktet e DPS-së gjatë vitit 2016 do të jenë:

- Adoptimi i rreth 2,000 standardeve evropiane si standarde shqiptare (SSH);
- Adoptimi i rreth 500 standardeve ndërkombëtare si standarde shqiptare (SSH);
- Publikimi i standardeve në Katalogun të Standardeve Shqiptare;
- Përgatitja, publikimi dhe shpërndarja e 4 Buletinëve Informativë (çdo 3 muaj) mbi të rejat për standardet shqiptare;
- Takime me palë të interesuara për standarde të fushave si bujqësia, ushqimi, ndërtimi dhe vlerësimi i konformitetit;
- Përgatitja dhe publikimi i shkrimeve dhe njoftimeve sensibilizuese mbi përdorimin e standardeve me interes për ekonominë dhe konsumatorin.

Gjithashtu, deri në Mars 2016 DPS do të dërgojë në MZHETTS projekt Vendimin e Këshillit të Ministrave “Për Standardizimin në Shqipëri” që do të transpozojë plotësisht Rregulloren e BE nr.1025/2012. Miratimi i këtij Vendimi tregon angazhimin e vendit për të patur një sistem standardizimi në vend në përputhje me rregullat dhe mënyrën e funksionimit të standardizimit evropian dhe konkretisht, ndër të tjera, do të përcaktojë rregullat, të cilat në përputhje edhe me parimet e Organizatës Botërore të Tregtisë, për të inkurajuar dhe lehtësuar pjesëmarrjen e duhur të të gjitha palëve të interesuara, përfshirë këtu autoritetet publike dhe operatorët ekonomikë (SME-të), në gjithë veprimtarinë e standardizimit kombëtar.